




ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE



Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës Nr. 2004/7, nenit 27 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Kryetari i OEK shpallë këtë:

FTESË PUBLIKE PËR SHËRBIME PROFESIONALE TË ZHVILLIMIT DHE IMPLEMENTIMIT TË FUSHATËS SË NDËRGJEGJËSIMIT PËR SISTEMIN DUAL VET

Oda Ekonomike e Kosovës, në kuadër të projektit “Nxitja e inovacionit dhe qëndrueshmërisë për sistemin e arsimit dhe aftësisimit profesional dual në Kosovë, bën ftesë publike për dërgimin e ofertave për ofrimin e shërbimeve profesionale për zhvillimin dhe implementimin e fushatës së ndërgjegjësimit për Sistemin Dual të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (Dual VET), në kuadër të Aktivitetit A1.1 – Zhvillimi dhe Zbatimi i Strategjisë së Fushatës së Ndërgjegjësimit.

SHËRBIMET E KËRKUARA:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Zhvillimi i strategjisë së fushatës së ndërgjegjësimit	Copë	1
2	Planifikimi i fushatës së aktiviteteve dhe përgatitja e planit të komunikimit	Copë	1
3	Krijimi i përmbajtjes digjitale për rrjete sociale	/	/
4	Produksioni i videove të shkurtra promovuese	Copë	25
5	Krijimi i animacioneve / motion graphics për qëllime promovuese	Copë	20
6	Fotografim profesional për nevojat e fushatës dhe aktiviteteve të projektit	Ditë	20 ditë
7	Përgatitja e materialeve vizuale për përdorim në evente, trajnime dhe komunikim publik (LED Screen design, materiale promovuese për portalet online)	/	/
8	Koordinim dhe mbështetje profesionale gjatë implementimit të fushatës	/	/

Kërkesat për ofertuesin

- Ofertuesi (kompani ose ekip profesional) duhet të ketë përvojë të dëshmuar në fushën e komunikimit, marketingut dhe fushatave ndërgjegjësuese;
- Duhet të ketë kapacitete profesionale për realizimin e shërbimeve të kërkuara;
- Angazhimi i ekspertit kryesor parashihet për një periudhë **deri në 12 ditë pune**, në përputhje me nevojat e aktivitetit.

Dokumentacioni i kërkuar

- Certifikata e plotë e biznesit ku përshkruhen veprimtaritë e regjistruara
- Ofertën financiare (çmimi total për shërbimet e kërkuara pa e përfshirë TVSH) e cila përmbanë vulën dhe nënshkrimin e personit të autorizuar.
- Përshkrimin teknik të qasjes/metodologjisë;
- 2 referenca relevante;



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Dokumentet duhet të dërgohen në email: arsimidual@oek-kcc.org, duke shënuar në subjekt: "Ofertë për ftesë publike – Fushata e ndërgjegjësimit Dual VET", më së largu deri më 28.01.2026, ora 12:00.

Ftesa publikohet në uebfaqen zyrtare dhe në Facebook-un e Odës Ekonomike të Kosovës.

Kriteri i përzgjedhjes së ofertës fituese është **çmimi më i volitshëm i ofertuar**, duke marrë parasysh përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale.

Ofruesi i shërbimit duhet ta ketë parasysh se projekti zbatohet deri në fund të periudhës **gusht 2026** dhe përfshin deri në **dy aktivitete në muaj**, ndërsa çmimi total i ofertuar duhet të mbulojë të gjitha shërbimet e kërkuara për realizimin e fushatës së ndërgjegjësimit dhe materialeve promovuese për të gjitha aktivitetet e planifikuara deri në përfundim të projektit, pa kosto shtesë për OEK.

Fushata e ndërgjegjësimit dhe materialet promovuese synojnë të mbështesin promovimin e përfitimeve të Sistemit Dual të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (Dual VET) për sektorin privat, të rrisin vizibilitetin e aktiviteteve të projektit dhe të sigurojnë komunikim të qëndrueshëm dhe të koordinuar gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit.

Vlera totale e parashikuar: **10,000.00 EUR**.

Lulzim Rafuna
Kryetar
Oda Ekonomike e Kosovës

